Aktualitet

Elbasan/ Ekzekutohet me silenciator 41 vjeçari në makinë në sy të gruas! Vite më parë iu vra vëllai dhe kushëriri, lidhja me 2 vrasjet e bujshme të korrikut 2020! 2 autorët në kërkim (VIDEO)

Një 41-vjeçar është ekzekutuar mbrëmjen e sotme në sy të gruas së tij në makinë në lagjen "Skëndërbej" në Elbasan. Viktima është identifikuar si Everest Çaka, teksa si pasojë e të shtënave me armë ka mbetur e plagosur në dorë gruaja e tij. Në vendin ku është kryer ekzekutimi të vetmet kamera sigurie janë të një shtëpie 150 metra larg vendit të ngjarjes, teksa zona përreth është errësirë.

- U ekzekutua sot në makinë, del fotoja e viktimës dhe gruas së tij e cila mbeti e plagosur
- Iu bë pritë në makinë, 41-vjeçari që u ekzekutua në Elbasan njihej me dy emra
- Ekzekutimi i Everest Çakës në Elbasan, gjendet një automjet i djegur në Kavajë, dyshohet i autorëve
- Report Tv sjell pamje nga vendi i ngjarjes, viktima brenda në makinë
- Në vendin e ngjarjes Ardi Veliu dhe kryeprokurori Ajazi
- Ekzekutimi i Çakës, në vendin e ngjarjes s'ka kamera sigurie, vetëm 150 metra larg

[Sh.com] Redaksia
11 Maj, 20:11 | Përditesimi i fundit: 12 Maj, 11:18

Share

ELBASAN- Një 41-vjeçar është ekzekutuar me armë me silenciator mbrëmjen e sotme në makinë në sy të gruas së tij në lagjen "Skëndërbej" në Elbasan. Viktima është identifikuar si Everest (Ibrahim) Çaka, 41-vjeç nga Fushë-Mbreti, teksa si pasojë e të shtënave me armë ka mbetur e plagosur në dorë, jashtë rrezikut për jetën, edhe gruaja e tij, Silvana e cila ndodhej bashkë me të në makinë. Dyshohet se autorët që e kanë qëlluar kanë qenë 2 dhe ende nuk janë identifikuar. Report Tv ka sjellë pamje nga vendi i ngjarjes, nga momenti kur trupi i viktimës ndodhej ende në makinën e tij tip 'Opel' me targa AB 467 AB, për t'u çuar më pas në morgun e qytetit.

Shkak i vrasjes dyshohet se është e shkuara tij, kjo pasi Çaka ka lidhje me persona me të shkuar kriminale që kanë mbetur të vrarë pak vite më parë. Më konkretisht, atij i është ekzekutuar vëllai në Barcelonë si edhe kushëriri në Belgjikë. Bëhet fjalë për Ardit (Arjan) Spahiu. Ky i fundit është vëllai i kunatit të ***Erion Alibej***, i arrestuar nga prokuroria e Elbasanit si person i dyshuar për urdhërimin e organizimit të dy vrasjeve. Erion Alibej, organizatori i dy vrasjeve që tronditën qytetin e Elbasanit, më 20

dhe 29 korrik, ka porositur vrasjen e ***Emiljano Ramazanit*** dhe shokut të tij, ***Regis Runajt*** në Elbasan.

LEXO EDHE:

Deputeti i zgjedhur Klevis Xhoxhi vijon takimet me qytetarët e Elbasanit: Faleminderit që mbështet mua dhe Partinë Socialiste

Në vendin e ngjarjes janë forca të shumta policie, teksa i pranishëm është edhe vetë drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Ardi Veliu dhe prokurori Kreshnik Ajazi. Shërbimet e Policisë kanë rrethuar zonën, teksa janë ngritur pika kontrolli në hyrje - daljet në qytetin e Elbasanit dhe vijon kontrolli i zonës. Në vendin ku është kryer ekzekutimi të vetmet kamera sigurie janë të një shtëpie 150 metra larg vendit të ngjarjes, teksa zona përreth është errësirë.

Kjo është vrasja e tretë brenda 2 ditësh. Një ditë më parë, 10 maj, u ekzekutua me breshëri kallashnikovi në zonën e quajtur 'Bishti i Kalldrëmit' në Vlorë, ***Bledar Birçaj***, teksa mbrëmjen e djeshme mbeti i vrarë ***Mehmet Qema*** nga Hasi. Ai u ekzekutua me një plumb në gjoks, nga miku i tij Marjus Dema, 28 vjeç, i cili u vetëdorëzua më pas në polici.

Viktima Everest Caka dhe e shoqja Silvana



Foto nga vendi i ngjarjes, makina me viktimën brenda

Share

Ora 23:11

Ekzekutimi në Elbasan/ Dalin pamjet, kjo është makina e djegur që dyshohet se i përket autorëve

Report Tv ka siguruar pamje nga makina e djegur që dyshohet se u përket autorëve që ekzekutuan Everest Çakën. Makina është tip "Benz", pa targa dhe është gjetur në zonën e stacionit hekurudhor në Golem të Kavajës.

Share

Ora 22:04

Iu bë pritë në makinë, 41-vjeçari që u ekzekutua në Elbasan njihej me dy emra

41-vjeçari që u ekzekutua me armë zjarri mbrëmjen e sotme në Elbasan njihej me dy emra. Njëri nga identitetet ishte Everest Çaka dhe tjetri Ibrahim Çaka.

Share

Ora 22:01

Ekzekutimi i Everest Çakës në Elbasan, gjendet një automjet i djegur në Kavajë, dyshohet i autorëve

Vetëm pak minuta pas ekzekutimit të Everest (Ibrahim) Çakës në Elbasan, një automjet i djegur është gjendur në Kavajë, që dyshohet se i përket autorëve të ngjarjes. Automjeti tip "Benz", pa targa, është gjetur në fshatin Kryemëdhenj, Golem, i djegur plotësisht.

Share

Ora 21:45

41 vjeçari u vra me armë me silenciator, 2 janë autorët që e kanë qëlluar



41 vjeçari Everest Çaka është vrarë me armë me silenciator mbrëmjen e sotme në Elbasan. Burime për Report Tv bëjnë me dije se kanë qenë 2 persona që e kanë qëlluar, të cilët ende nuk janë identifikuar.

Share

Ora 21:28

U ekzekutua sot në makinë, del fotoja e viktimës dhe gruas së tij e cila mbeti e plagosur

Ky është Everest Çaka që u vra sot në Elbasan dhe gruaja e Silvana e cila mbeti e plagosur nga të shtënat.

Share

Ora 21:16

Vrasja në Elbasan, mbërrin në vendin e ngjarjes Ardi Veliu dhe prokurori Ajazi

Pas vrasjes së Everest Çakës në Elbasan në vendin e ngjarjes ka mbërritur drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Ardi Veliu dhe prokurori Kreshnik Ajazi.

Share

Ora 21:09

Ekzekutimi i Çakës, në vendin e ngjarjes s'ka kamera sigurie, vetëm 150 metra larg



Detaje të reja zbardhen nga vrasja e Everest Çakës brenda në makinën e tij tip "Opel" në Elbasan. Në vendin ku ka ndodhur vrasja nuk ka kamera të cilat mund të hedhin dritë në këtë ngjarje. Vetëm 150 metra larg vendit të ngjarjes është një banesë me kamera sigurie që mund të ndihmojë hetimet.

Share

Ora 20:52

Ekzekutimi në Elbasan/ Policia jep njoftimin zyrtar

Policia ka dhënë njoftimin zyrtar lidhur me ekzekutimin e 41-vjeçarit, Everest Çakës në Elbasan.

> *"Rreth orës 20:10, në lagjen "Skënderbe", Elbasan, në rrethana ende të paqarta është vrarë me armë zjarri në mjet shtetasi E.Ç, rreth 41 vjeç si dhe është plagosur në dorë bashkëshortja e tij shtetasja S.Ç., jashtë rrezikut për jetën.*
>
> *Shërbimet e Policisë kanë shkuar menjëherë në vendngjarje dhe kanë rrethuar zonën.Janë ngritur pika konrolli në hyrje - daljet në qytetin e Elbasanit dhe vijon kontrolli i zonës.*
>
> *Grupi hetimor nën drejtimin e Prokurorisë ndodhet në vendngjarje dhe vijon puna për zbardhjen e plotë të shkakut dhe rrethanave të ngjarjes si dhe identifikimin e kapjen e autorit/ve", njofton Policia.*

Share

Ora 20:48

Atentati në Elbasan/ Viktima kushëri me Arjan Spahiun, të ekzekutuar në Bruksel...lidhja me vrasjen e Emiljano Ramazanit dhe Regis Runajt

Report Tv mëson se viktima i atentatit të sotëm, Everest Çaka është djali i tezes së Ardit (Arjan) Spahiu. Ky i fundit është ekzekutuar me 8 plumba në Bruksel ***në nëntor të 2020***. Vite më parë atij i është vrarë edhe vëllai.

Kush është Ardit (Arjan) Spahiu? Spahiu është vëllai i kunatit të ***Erion Alibej***, i arrestuar nga prokuroria e Elbasanit si person i dyshuar për urdhërimin e organizimit të dy vrasjeve.

Erion Alibej, organizatori i dy vrasjeve që tronditën qytetin e Elbasanit, më 20 dhe 29 korrik, ka porositur vrasjen e ***Emiljano Ramazanit*** dhe shokut të tij, ***Regis Runajt*** në Elbasan. Uniformat blu ***e arrestuan*** më 18 shtator në Elbasan.

Ardit (Arjan) Spahiu

Erion Alibej, Emiljano Ramazani dhe Regis Runaj

Share

Ora 20:42

U ekzekutua në makinë në sy të gruas, zbulohet identiteti i viktimës



Everest Çaka është personi i ekzekutuar mbrëmjen e sotme në Elbasan. Ai është nga Fushe Mbreti.

Share

Ora 20:41

Detaje nga atentati në Elbasan/ Ekzekutimi në sy të bashkëshortes, gruaja mbeti e plagosur në dorë

Report Tv ka zbuluar detaje të reja nga atentati në Elbasan. Everest Çaka është ekzekutuar në sytë të bashkëshortes së tij, Silvana Çaka. Si pasojë e të shtënave me armë ka mbetur e plagosur në dorë, jashtë rrezikut për jetën

Share

Ora 20:25

Vrasja në Elbasan, bashkë me viktimën në makinë ndodhej edhe një vajzë

Personi i vrarë mbrëmjen e sotme në Elbasan është qëlluar teksa ka qenë në makinën e tij tip “Opel”. Bashkë me të në makinë ndodhej edhe një vajzë.

Share

Ora 20:14

Atentat në Elbasan/ Zona e 'blinduar' nga Policia, Report Tv sjell pamje nga vendi i ngjarjes, viktima brenda në makinë

Report Tv ka sjellë pamje nga vendi i ngjarjes ku u regjistrua atentati vetëm pak minuta më parë. Siç shihet në pamje, viktima ishte ende në makinë, teksa më pas është transportuar drejt morgut të qytetit. Forca të shumta policie ndodhen në vendin e ngjarjes.

Share

Be.K./Shqiptarja.com

TAG: elbasan | vrasje | te shtena me arme | Silvana Çaka | Everest Çaka | vrasja e everest cakes | Arjan Spahiu

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH .COM

Sondazhi i ditës:
Atentate mafioze dhe vrasje, a ndiheni të rrezikuar nga kriminaliteti në rritje?

Po | Jo | Nuk kam mendim

Komento

Komente

Njoni: 12/05/2021 07:12

Te kthehet mond koseni drejtor policije ose në vlor ose në elbason dhe te shkioj gjith shqiperia ca dryshimo nga vetem ai Di si sillet në ke ta (Trima) qe vrasin e presin

Përgjigju

xoni: 12/05/2021 04:43

Mjaft me vrasjet o njerez..nuk zgjidhen problemet keshtu,,,nuk jemi popullsi 300.milion...

Përgjigju

Besart: 11/05/2021 22:05

po ca behet o Shqiperi!!! na ke tmerruar !!! ikni me vrap qe ktej se do ju iki jeta dem!

Përgjigju

doqja: 11/05/2021 22:00

Vlor Elbasan rekord vrasjesh elbasani po mundoet te parakaloj vloren deri tani ne vlore jan vrar 3persona zere 4 se ai marjon mitro qe pagonte jul sinanajn shpetoi kot vetem ne 2021 flasim se vjet u vran 7 veta si ne vlore si ne elbasan

Përgjigju

Beni: 12/05/2021 01:14

O Doqje ke pas ndonje cike pune keto kohe,apo po pret sezonin veror

Elion: 11/05/2021 23:01

Vrasja do lek o shok. Po e cove muabetin deri te vrasja ke bo shume leke me u rujt nga polici, prokurori, avokati, gjykatesi duhet me pas lek edhe me lon familjen rehat nderkohe qe je i ncef ose mren. Problemi me kto vitet e funit eshte qe shteti i la tgjith me bo lek. 2 3 grupe sarande, 3 4 vlore, 3 4 lac/lezhe, 3 4 shkoder pa permen Durrsin e Tironen qe dihen. Edhe kur bohesh me lek nuk ke mo frike me hap i muahabet tvjeter apo me i ra hasmit kur se pret. Llogarit edhe i 50-100 cuna te ri ish polica, komando etj qe varferia i ka pranu me bo ca do lloj pune. Se nfillim si roje kan fillu te shkretet, por pastaj gjonat kthehen personale, edhe merr zemer komando thot, e shkrep une per ty. Se u zgjata. Ska thon kot ai prokurori qe mafia sja doli dot ne itali dhe i vuni 100kg tritol. Ndiq lekun. Po mbylle rubinetat e lekut ska mo vrasje mafioze.

Beni: 11/05/2021 22:37

O Doqje ke pasur ndonje cik pune?

Visi: 11/05/2021 21:01

Po behen gati per zgjedhje te parakohshme

Përgjigju

Lajme të tjera

Aktualitet

Fitër Bajrami, Basha uron besimtarët myslimanë: Agjërim dhe lutje të pranuara

12 Maj, 22:39

Aktualitet

Politika uron Fitër Bajramin, Ruçi: Festival i vlerave shpirtërore! Meta: Sakrificat na kujtojnë se duhet të mbrojmë demokracinë

12 Maj, 22:34

Aktualitet

VIDEO, shokojnë dy të rinjtë, "sfidojnë" vdekjen dhe ecin buzë ndërtesës së lartë në Tiranë

12 Maj, 21:19

Aktualitet

Ekskluzive/ Ambasadori i Izraelit për Report Tv: Jeruzalemi është përdorur si një justifikim! Nuk diskutohet heqja dorë nga qyteti i shenjtë

Suada Mehmetaj

12 Maj, 21:04

Aktualitet

Ministrja Kushi, bashkëbisedim me maturantë: Vështirësitë gjatë pandemisë do të reflektohen në Maturën Shtetërore 2021

12 Maj, 20:58

Aktualitet

Falja e Fitër Bajramit në sheshin 'Skënderbej'/ Ish-myftiu i Tiranës: Distanca vështirë të ruhet, do shpërndajmë maska anti-COVID për besimtarët

12 Maj, 20:45

© 2011 - 2021 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje